



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2010

Grupi punues:

1. Rufki Suma, kryetari i komunës
2. Muzafer Dernjani, nënkryetari i komunës
3. Fari Kalisi, drejtor për Administratë të Përgjithshme
4. Shabi Rexhallari, drejtor për Ekonomi, Buxhet dhe Financa
5. Nazim Laçi, drejtor për Arsim dhe Kulturë
6. Safet Bushi, drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Nexhmedin Daci, drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
8. Rufat Shkreta, drejtor për Shëbime Publike dhe Emërgjencë
9. Ajete Berisha, menaxhere e Personelit
10. Xhevdet Bushi, shef i zyrës së Prokurimit
11. Bajrush Laçi, zyra ligjore
12. Bashkim Sopa, zyra për Transparecë

Janar 2011

Pjesa e përgjithshme

Puna e kryetarit është bazuar në dokumentet bazë siç janë: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit dhe plani i punës së kryetarit.

Aktiviteti i kryetarit për vitin 2010 është fokusuar në këto fusha:

- Konstituimi i organeve komunale pas zgjedhjeve lokale 2009
- Hartimi dhe përrirja e infrastrukturës ligjore në kuadër të komunës
- Bashkëpunimi i komunës me qeverinë dhe faktorin ndërkombëtar në Kosovë
- Vazhdimi i kontinuitetit të projekteve të filluara dhe implementimi i projekteve prioritare për vitin 2010
- Ngritja e kapaciteteve teknike dhe humane në kuadër të komunës

❖ **Konstituimi i organeve komunale pas zgjedhjeve lokale 2009**

Implementimi i rezultateve të zgjedhjeve lokale 2009, është bërë sipas kësaj dinamike:

Detyrën e kryetarit e kam pranuar me 28 dhjetor 2009, në afat sa më të shkurtër, sipas LVL dhe Statutit të komunës së Hanit të Elezit, është thirrur mbledhja konstituive e Kuvendit të Komunës e cila është mbajtur me 12 janar 2010, ku nga kjo mbledhje e kuvendit u zgjodh Kryesuesi i kuvendit z. Mendu Vlasi, ndërsa me 22 janar 2010 është kompletuar zyra e kryetarit të komunës, duke emëruar, nënkryetarin dhe drejtorët e drejtorive në këte përbërje:

- Nënkryetar i komunës – Muzafer Dernjani
- Drejtor i Administratës së Përgjithshme- Fari Kalisi
- Drejtor për Ekonomi financa dhe Bujqësi – Shabi Rexhallari
- Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit – Nexhmedin Daci
- Drejtor për Arsim, Kulturë – Nazim Laçi
- Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Safet Bushi
- Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë – Rufat Shkreta

Dhe me këtë me sukses është rrumbullakuar implementimi i rezultateve të zgjedhjeve lokale 2009, në komunën e Hanit të Elezit.

❖ **Hartimi dhe përtrirja e infrastrukturës ligjore në kuadër të komunës**

Një ndër prioritetet e administratës së komunës ishte aplikimi i ligjshmërisë, në kuadër të saj dhe hartimi i rregulloreve për të përligjësuar të gjitha aktivitetet e saja. Në kudër të saj gjatë kësaj periudhe janë miratuar këto rregullore:

- **Plotësimi dhe ndryshimi i statutit të komunës**
- **Miratimi i Statutit të QKMF-së**
- **Rregullorja për tatim në pronë**
- **Rregullorja për taksa tarifa dhe ngarkesa**
- **Rregullorja për shërbimeve publike**
- **Rregullorja për mbrojtje të ambientit**
- **Rregullorja për bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje.**
- **Rregullorja për përdorimin e gjuhëve dhe**
- **Rregullorja për punën e komiteteve.**

Të gjitha këto rregullore kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat ligjore për miratim.

Gjithashtu janë konstituuar tre komitete konsultative si:

- Komiteti për zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe mbrojtje të ambientit
- Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Komiteti për Shërbime Publike

❖ **Bashkëpunimi i komunës me Qeverinë e Kosovës dhe faktorin ndërkombëtar në Kosovë**

Bashkëpunimi i administratës komunale, gjatë kësaj periudhe është shumë i begatshëm duke filluar nga qeveria ku me sukses kemi vazhduar projekte të ndryshme, si që janë asfaltimi i rrugës Hani i Elezit- Gorancë me MTT, rregullimi i kanalizimit në Paldenicë me MAPL, konsulta të ndryshme me të gjitha ministritë. Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm siqë janë USAID-i, ZKE-në, UN-Habitat, EULOG, LOGOS, CDI, si dhe me institucionet monitoruese OSBE dhe KFOR-in.

Është ngritur qështja e emërimit të Hanit të Elezit me Gjeneral Jankoviq në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si dhe janë njoftuar të gjitha institucionet e Kosovës e sidomos MEF-i për mospërdorimin e këtij emërtimi në faturat e tatimit në pronë, në të kundërtën do të refuzohen të gjitha vendimet e tilla me këtë emërtim.

Në kudër të bashkëpunimit janë realizuar edhe dy vizita pesë ditore me karakter pune e kryetarit në muajin maj në Suedi si dhe në Hungari në korrik. Që të dy këto vizita u organizuar nga UN-HABITAT-i.

Në sajë të bashkëpunimit të mirë janë lidhë këto marrëveshje:

1. Marrëveshja me qytetarët e Rezhancës dhe Meliqëve për hapjen e trasesë së rrugës Hani i Elezit-Gorancë
2. Marrëveshja me MAPL për financimin e ndërtimit të Kanalizimit fekal në Paldenicë dhe rrjetit të intranetit në objektin e administratës Komunale.
3. Marrëveshje mirëkuptimi për bartjen e pajisjeve të teknologjisë informative nga MAPL-ja në komunë të financuar nga Banka Botërore (7 kompjuter, 1 llaptop, 1 projektor, 1 printer i rrjetit)
4. Marrëveshje mirëkuptimi me MAPL-në për transferin e paisjeve teknologjike (20 kompjuter)
5. Marrëveshja me OVL UÇK-në për mirëmbajtjen e kompleksit të Varrezave të Dëshmorëve në Puset e Nikës
6. Marrëveshje e mirëkuptimit për Rehabilitimin shëndetësor për familjet e Dëshmorëve në Banjën e Kllokotit.
7. Marrëveshje mirëkuptimi me Intercooperation-Logos për ndihmë në administratë dhe shërbime publike
8. Marrëveshja me UN-HABITAT-in për hartimin e planit zhvillimor komunal dhe Planit Zhvillimor Urban
9. Marrëveshja me GTZ- për ngritje të kapaciteteve në zyrën e kadastrit
10. Marrëveshje bashkëpunimi me AZHR-L (Agjensionin për Zhvillim Rajonal-Lindje)
11. Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë Departamentin e Shërbimit Sprovues, për vuajtjen e dënimeve alternative për të mitur në territorin e komunës.
12. Marrëveshja me ZKE- ndërtimin e sallës së sporteve në sh.f. "I.Thaqi" në Han të Elezit
13. Marrëveshja me komunën e Kaçanikut për transferimin e dokumentacionit kadastral në Han të Elezit.

❖ Vazhdimi i kontinuitetit të projekteve të filluara dhe implementimi i projekteve prioritare për vitin 2010

Meqenëse disa projekte të rëndësishme për komunën tonë ishin ende të pa përfunduara, menjëherë kam vendosur kontaktet me donatorët dhe kryesit e punëve, të gjitha këto projekte kanë vazhduar me dinamikën e punës të përcaktuar paraprakisht. Gjithashtu falë bashkëpunimit të mirë me institucionet qeveritare dhe donatorë të tjerë gjatë këtij viti u realizuan apo janë në përfundim e sipër, pesëmbëdhjet projekte kapitale, dymbëdhjet janë implementuar në tërësi ndërsa tre janë në përfundim e sipër. Ato janë: Rruga Hani i Elezit-Gorancë, Rruga Hani i Elezit-Paldenicë, dhe rregullimi i sheshit të qytetit.

Në këto projekte janë investuar **3,970.367.94** euro. Prej tyre administrata komunale **453,094.00**, Qeveria-ministrinë **2,514.273.94** €, donator 1,003.000 €

❖ Ngritja e kapaciteteve teknike dhe humane në kuadër të komunës

Gjatë kësaj periudhe vëmendje i është kushtuar, pajisjes së zyrtarëve komunal me pajisje teknike të cilat kanë përmirësuar cilësinë dhe kualitetin e shërbimeve për qytetar, siqë janë pajisja me teknologji informative e zyrës së kadastrit, instalimi i pajisjeve të zërimit në sallën e kuvendit, instalimi i rrjetit të intranetit në objektin e administratës komunale, instalim i pajisjeve vizuale-kamerave në pikat më frekuentuese të administratës komunave (hyrja dhe zyra e pritjes)

Ndërsa ngritja e kapaciteteve humane – profesionale e zyrtarëve të Komunës pothuaj se për çdo javë pëcjellin seminare të ndryshme të organizuar nga ministritë përkatëse, USAID-i EULOGU-u, me tema si që janë: menaxhimin i resurseve njerëzore, procedurat ligjore në qeverisjen lokale, menaxhimi i buxhetit, planifikimet zhvillimore strategjike etj, të cilat kanë qenë të mirëseardhura për zyrtarët komunal si në ngritje profesionale për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave në kuadër të aktiviteteve të tyre zyrtare, dhe shërbim cilësor dhe profesional të qytetarëve.

Gjatë vitit 2010 për çdo muaj janë mbajtur mbledhjet e KKSB-ve (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi), mbledhje me kryetarët e fshatrave (2 mbledhje), janë mbajtur 4 debate me qytetarë dhe 3 dëgjime publike.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Drejtoria e administratës së përgjithshme për periudhën JANAR –DHJETOR - 2010 aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave të cilat i ka parashtruar vetes në bazë të kompetencave dhe planit të punës për vitin 2010 .

Ky aktivitet i administratës është drejtuar përmes zyrave të cilat e përbëjnë strukturën organizative të administratës, bazuar në kompetencat dhe autorizimet që i ka drejtori i administratës gjatë këtij viti është fokusuar në shtimin e stafit në Administratën Komunale, ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, në dhënien e ndihmave të nevojshme dhe informimit të drejtë të tyre për realizimin e të drejtave të tyre .

Drejtoria e administratës një angazhim të madh dhe të veçante ka pasur në drejtim të bashkëpunimit me MAPL-në (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) ku mbanë takime të rregullta mujore, MAP (Ministria e Administratës Publike), MPB (Ministria e Punëve të Brendshme).

Drejtori i Administratës në muajin mars ka zhvilluar trajnimin pesëditor me temën “menaxhimi i burimeve njerëzore” në Holandë në bashkëpunim me EULOG-un, ndërsa në Ohër të Maqedonisë kam realizuar trajnimin treditor me MAPL-në.

Drejtori i Administratës me vendim të Kryetarit është caktuar si person kontaktues me MAPL-në, ndërsa MAPL-ja si person kontaktues me komunën ka zyrtarin përgjegjës të monitorimit .

Gjatë këtij viti kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme - Departamenti i Gjendjes Civile- për hapjen e zyrës për dhënien e dokumenteve personale si dhe hapjen e zyrës për regjistrimin e automjeteve për qytetarët e Hanit të Elezit .

Gjatë këtij viti kemi bërë kërkesë për deponim të nënshkrimit për Drejtorin e Administratës dhe zyrtarin e Ofiqarisë, sepse në Komunën vetëm një zyrtar ka pasur të drejtë për nënshkrimin e dokumenteve që lëshohen nga zyra e Ofiqarisë , ku kërkesa është realizuar .

Drejtori i Administratës ka pasur takime të rregullta me punëtorët e sektorit rreth punëve dhe problemeve të këtij sektori, kurse rregullisht gjatë orarit të punës janë vizituar punëtorët nëpër zyre .

Është bërë sistemi i menaxhimit të vijimit të punëtorëve në punë.

Vendosja e kamerave në hyrje të objektit të Komunës dhe të zyrës së pritjes

Projekti i E-qeverisjes për forcimin e standardizimit të faqeve të internetit

Shtrimi i rrjetit të Intranetit në objektin e Komunës të financuar nga MAPL

Instalimi i skanerit digjital në zyrën e pritjes sinkronizimi dhe licencimi e serverit tonë me serverin e MAP-së , qasja interaktive e të gjithë drejtorive , zyrës së Kryetarit , Kryesuesit të Kuvendit .

Gjatë këtij viti është bërë lysterja (fasadimi) e zyrave të objektit të Komunës .

Vendosja e klimave në gjitha zyret e Komunës

Shtrimi i tepisonave në disa zyre të Komunës

Themelimi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut të Komunave (NJDNJK)

Është bërë regjistrimi i inventarit të Administratës së Komunës dhe është duke vazhduar barkodimi i inventarit .

Është bere regjistrimi i pajisjeve që janë të pa përdorura dhe eliminimi i tyre.
Nga Ministria e Punëve të Brendshme janë marrur të gjitha librat Amë të gjendjes civile ku janë bërë kopje si dhe janë kthyer .
Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative nga MAPL-ja

Në kuadër të drejtorisë së administratës veprojnë këto zyre;

ZYRA E PRITJES- Shërbimi i Shkrimores ka bërë regjistrimin ,evidentimin përcjelljen dhe shpërndarjen e 2.794. lëndëve duke përfshirë të gjitha sektorët dhe shërbimet e kuvendit të Komunës, 7327 lëndë për zyrën e ofiqarisë .
Është bërë verifikimi i origjinalitetit të 198 diplomave.

ZYRA E OFIQARISË;Sektori i ofiqarisë i cili vepron në kuadër të sektorit të administratës është një zyre e cila është e angazhuar,funksionon shumë e organizuar .
Shprehur në shifra ky shërbim ka kryer këto shërbime për palë;

Janar – Dhjetor

1. Regjistrim të Lindjeve.....	3
2. Regjistrim të Kurorëzimeve.....	84
3. Regjistrim i vdekjeve.....	23
1. Regjistrime i lindjeve jashtë vendit.....	143
2. Regj. i vdekjeve nga jashtë.....	3
3. Regj. i kurorëzimeve nga jashtë.....	20

Janar – Dhjetor

1. Aktvendime për regjistrim të më vonshëm në LAL.....	2
2. Aktvendime për regjistrim të vdekjes në LAV.....	5
3. Aktvendime për ndryshimin dhe përmirësimin e emrit dhe mbiemrit....	11
4. Aktvendime për harmonizimin e datës së lindjes.....	2
5. Vërtetime mbi fitimin e shtetësisë së Kosovës.....	5
6. Aktvendim për anulim për regjistrim në LAL	1

Gjatë kësaj periudhe janë inkasuar 11.367.50€duke mos llogaritur ato kategori të cilat sipas vendimit komunal janë të liruar nga taksa.

ZYRA E ARKIVIT

Zyra e arkivit ka filluar të funksionon nga data 01.02.2009. Fillimisht detyrë e kësaj zyre ka qene grumbullimi i materialit qe sipas rregullës duhet te procedohet si material arkivor. Kjo zyre është duke vazhduar me arkivimin e lëndëve në zyrën e arkivit sipas planit 2010, vazhdon edhe digjitalizimin elektronik i të dhënave ,me një përshkrim te shkurt te përmbajtjes se dokumentit, dhe burimit te dokumentit. Gjatë vitit 2010 është bërë instalimi i sistemit me serverin e zyrës së pritjes për ruajtjen e të dhënave në mënyrë elektronike.

DEPOJA

Depoja ka vazhduar me furnizimin me material për Administratën Komunale sipas planit dhe nevojave si dhe shpërndarjen e materialit në bazë të kërkesave të zyrtarëve të miratuara nga Kryetari si dhe ka bere regjistrimin e materialit . Vitin 2010 në depo është bërë instalimi i sistemit të e-pasurisë, ku është duke u bere regjistrimi i materialit që hyn në depo. Në depo është bere instalimi i aparatit të barkodimit si dhe ka filluar regjistrimi i inventarit

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

1. **Zotimet e mjeteve financiare** :- ky aktivitet ka të bëjë me ndarjen e mjeteve buxhetore për një furnizim ,punë apo shërbim që do të kryhet në të ardhmen Me këtë aktivitet kemi filluar me datën 03.02.2010 me zotimin e parë lidhur me Shpenzimet e rrymës ne vlerë prej 1,606.21 euro.

Deri me tani kemi bërë gjithsej 405 zotime ne vlerë te përgjithshme prej 692,349.78 € për këto kategori ekonomike: mallra & shërbime, subvencione & transfere, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale.

2. **Regjistrimi i të HVK:-** ky aktivitet përfshinë regjistrimin ditor dhe të dyfishtë (në sistemin e freebalancit dhe ne exell) barazimin intern si dhe barazimin me MEF-in në periudha tremujore, alokimin e të hyrave komunale etj.

Përgjatë kësaj periudhe kemi bërë barazimin me MEF-in për periudhën janar – shtator 2010 , ndërsa ne tremujorin e fundit presim te bëjmë barazimin ne ditët ne vijim . Lidhur me qështjen e barazimeve pas çdo barazimi kemi kërkuar alokimin e HVK – ne kategori ekonomike kryesisht projektet kapitale, për këtë lëmi te aktivitetit tone gjate vitit 2010 zyra për buxhet dhe financa ofron dy tabela : 1) tabela për te hyrat komunale sipas sektorëve dhe 2) tabela mbi krahasimet e viti 2009/10 sipas llojit te të hyrave vetanake.

3. **Informimi i vazhdueshëm mbi gjendjen e Buxhetit:-** zyra për buxhet dhe financa për gjatë kësaj periudhe në çdo kohë ka informuar lidhur me të hyrat dhe të dalat komunale, përkatësisht njoftimi i vazhdueshëm i menaxhmentit lidhur me gjendjen e mjeteve financiare : të alokuara,të zotuar, të shpenzuara për të gjitha kategoritë ekonomike si dhe arkëtimin e të hyrave vetanake . Lidhur me këtë aktivitet janë përgatitur tri tabela ; 1) Buxheti 31.12.2010 gjendja , 2) Ekzekutimi i buxhetit sipas kodeve ekonomike dhe 3) Gjendja e Projekteve kapitale me 31.12.2010.

4. **Mbajtja e Pety – Cash-it;** ka të bëjë me ekzekutimin e pagesave urgjente dhe me vlerë nën 100.00 euro.

Gjatë kësaj periudhe kemi bërë një mbushje fillestare të arkës në vlerë prej 2,500.00 euro me dt.19.02.2010 dhe me vone kemi bere rimbushjen e pare në këtë vit me datën 17.09.2010 ne vlere prej 2.474.92 euro . Gjate vitit 2010 me para te gatshme kemi shpenzuar gjithsej 4.994.35 euro.

5. **Pranimi i Mallrave:** Ka te bëje me pranimin e mallrave dhe shërbimeve që blihen me procedure te prokurimit,ku çdo raport i pranimit e ka edhe GRN e vet. Gjate vitit 2010 kemi pranuar gjithsej 114 lëndë ne vlere prej 465.934.46 euro.

6. **Regjistrimi i Shpenzimeve në SIMFK:** me decentralizimin e thesarit qendror dhe regjistrimin e shpenzimeve në thesaret komunale ne deri më tani kemi ekzekutuar 274 lëndë nga mallrat & shërbimet ,subvencionet, komunalit,dhe kapitalet në vlerë të gjithëmbarshme prej 217,284.00 €

7. **Aprovimi i shpenzimeve:** ka të bëjë transferimin e informacioneve lidhur me lëndët e shpenzuara nga thesari lokal në atë qendror e ky i fundit në Bankën Qendrore – llogaria e furnitorit pra me këtë edhe kryhen obligimet e komunës ndaj furnitorëve të saj.

8. **Mbledhja e parave publike dhe deponimi i tyre në bankë** ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe ku zyrtari për mbledhjen e parave ka bërë për çdo ditë grumbullimin e tyre nga drejtoria e Administratës dhe e Shëndetësisë lidhur me taksat e ndryshme administrative dhe deponimin e tyre në fund të ditës në bankë. Te hyrat e grumbulluara nga zyrtari i te hyrave vetanake te deponuara ne banke gjate vitit 2010 janë 14.565.10 euro.


9. **Mbajtja dhe regjistrimi i listave të pagave:-** gjithashtu përgjatë kësaj periudhe të raportimit kemi bërë regjistrimin e listave të pagave me të gjitha të dhënat përkatëse sipas muajve dhe drejtorive komunale dhe sistemimin e tyre nëpër follderë të veçantë.

10. **Pagesat e Tatimit në Pronë :** gjate kësaj periudhe përkatësisht gjatë këtij viti janë mbledhur taksat nga tatimi ne pronë dhe taksat nga regjistrimi i automjeteve. Sa i përket ankesave të tatimit në pronë kemi pasur gjithsej 36 ankesa, ku prej tyre 33 janë shqyrtuar dhe miratuar, 2 janë refuzuar dhe një është tërhequr gjatë kësaj periudhe. Kjo zyre ka arritur të inkasoje një shume prej 54.228.84 €

TOTALI I ARKËTIMIT NGA TATIMI NË PRONË NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT I KALKULUAR SIPAS ZONAVE KADASTRALE

Nr. rëndor	Zona Kadastrale	Të paguara
1	HANI I ELEZIT	32.481.72
2	PALDENICË	5.908.87
3	GORANCË	1.984.89
4	REZHANCË	1.041.74
5	PUSTENIK	830.22
6	KRIVENIK	768.19
7	DIMCË	2.024.43
8	DËRMJAK/NEQAVC	621.51
9	SEÇISHTË	8.567.27
Gjithësejtë		54.228.84€

TABELA GRAFIKE



Për të qenë Zyra e Tatimit në Pronë një zyrë funksionale është nevojë imediate për zgjerimin e stafit të saj, të paktën me dy zyrtar një gjeodet dhe një zyrtar si inkasant, sepse pa këto zyrtar kjo zyrë nuk mund t'i plotësojë as kushtet minimale për të funksionuar si zyre.

11. Inspektorati i Komunikacionit, Biznesit dhe Tregut : sa i përket inspektimit janë bërë inspektime të vazhdueshme neper te gjitha subjektet afariste qe ushtrojnë aktivitetin e tyre afarist ne territorin e Hanit të Elezit zakonshme ku ne kemi kontrolluar lokale te veprimtarive te ndryshme. Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë lëshuar 271 aktvendime mbi ngarkesat vjetore, ku shumta totale e këtyre aktvendimeve kapin shumën prej 119,675 €, ndërsa nga kjo shumë deri më tani kemi inkasuar 81.615 €apo 68.20%. Gjithashtu numri i subjekteve afariste që kanë aplikuar për leje pune është 98 , ku prej tyre 92 janë pajisur me leje pune, ku kapin shumën prej 3.740 euro, kurse pjesa tjetër që nuk janë pajisur ka qenë si pasojë e atyre që nuk kanë qenë te kompletuara dokumentet .

Gjatë këtij viti kemi hasur edhe ca probleme për ato lokale afariste që nuk i kane përfill urdhëresat tona qe nuk janë pajisur me leje pune dhe kemi ardhur deri te mbyllja e 6 lokaleve afariste , ku pastaj janë rihapur me rregullimin e dokumentacioneve dhe pagesave të taksave komunale. Gjate këtij viti janë lëshuar edhe 15 leje pune për personat qe ushtrojnë afarizmin e tyre auto – taxi ku nga këto leje janë inkasuar 275 euro , si dhe dënimet mandatore në vlerë prej 250 euro.

12 SEKTORI I PYLLTARISË

Ky sektor ka filluar punën prej korrikut te vitit 2010 ,ku gjate kësaj periudhe janë ngritur 74 fletëparaqitje të prerëseve ilegal , ku prej tyre 17 fletëparaqitje janë penale dhe 57 janë fletëparaqitje për kundërvajtje qe do te thotë se janë dëmtuar pyjet për 213 m³ dru ose shprehur ne te holla 25.351.40 €

Gjate kësaj periudhe në pyjet private janë shqyrtuar 27 lëndë në një sasi prej 982.75 m³ , ku prej tyre janë përpunuar dhe paguar 951.26 m³ në një shumë prej 1903.30 € ,

ndërsa janë përcjellur 874.16 m³ , ndërsa kanë mbetur pa u përcjellur edhe 73.10 m³ dru .

Gjate kësaj periudhe kemi pasur konfiskim te masës drusore 23.7 m³ , ku te gjitha janë dhëne për nxemjen qendrore të komunës .

Gjatë këtij viti me vendimin e kryetarit të komunës së Hanit të Elezit janë pastruar pyjet në vendin e quajtur “Qeshma e Shahes” nga qytetarë të Hanit të Elezit, të cilëve i është lejuar të marrin dru zjarri për djegie në një sasi prej 364 m kub, ku të gjitha i janë dhënë pa pagesë.

13. Të ndryshme: gjatë kësaj periudhe kohore kjo zyre ka kryer edhe një mori aktivitete të ndryshme si pagesa dhe qeshjet tjera të lidhura me payrollin (ku kemi përgatitur pagesat retroaktive, largim nga lista e pagave ,regjistrimin e punëtorëve të rinj , ndryshimet e koeficienteve etj.

Regjistrimin e furnitorëve te ri në sistemin e freebalancit.

Përgatitja fillestare e cash-flow-it (plani i rrjedhjes së parasë) pastaj ndryshimi i mëvonshëm për arsye të përshtatjes me rishikimin e buxhetit dhe te gjitha lëvizjeve tjera ne buxhet gjate vitit 2010 .

Po në këtë periudhë kemi pasur edhe auditimin për vitin 2009 dhe janar-shtator 2010. Gjithashtu kemi asistuar edhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit 2010 dhe planifikimin e buxhetit 2011 .

Është bërë edhe regjistrimi i pasurive komunale në SIMFK dhe në excell.



Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

DKAK-së këtë vit ka pasë detyrë dhe obligim të realizojë plan-programin të cilin e ka paraparë në fillim të punës .Kështu që gjatë këtij viti ka bërë mbykqyrjen profesionale pedagogjike të institucioneve edukativo- arsimore ,duke filluar prej atij parafillor ,fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë;ka bërë përcjelljen permanente gjatë formimit të organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollave;ka zhvilluar aktivitete kulturore për festa komunale dhe shkollore;ka organizuar gara diturie dhe sportive ndërmjet shkollave;ka bërë riparime në shkolla aty ku është paraqitur nevoja: ka pajisur shkollat me inventar.Kështuqë përmes tyre është munduar të ngrisë cilësinë në mësim dhe të zhvilloj kreativitetin te nxënësit.

Objektet shkollore: Në shkollën e Seqishtës është bërë rrethimi i oborrit. SHML “Dardania” , sh.f.m.u”Ilaz Thaçi” dhe sh.f.m.u.”K. e Diturisë” janë pajisur me internet dhe telefoni fikse.Është lyer shkolla e fshatit Gorancë.Në sh.m.l.”Dardania” është bërë riparimi i ollukëve ,i WC-ve, i brinerit të nxemjes qendrore, pastrimi i rezervuarit të naftës,ngjyrosja e jashtme e shkollës (pjesa e përparme) ,janë riparuar mbi 100 banka e karriga , janë riparuar dritaret e shkollës është rregulla oborri i shkollës. Të gjitha këto punë janë kryer nga drejtori , puntorët teknik dhe të afërmit e drejtorit pa kurrfarë kompensimi. Te sh.f.m.u. “I.Thaçi” është rregulluar pjesa e sipërme te parkingu dhe janë ndërtuar shkallët emergjente. Sh.f.m.u.”V.Ballazhi” është ngjyrosur në pjesën e brendshme. Shkollat janë paisë edhe me inventar. Sh.f.m.u. “K. e Diturisë është pajisur me 140 banka dhe 280 karriga : sh.f.m.u. “I.Thaçi” me 200 karriga dhe 110 banka si dhe me dy kompjuter ,dy tavolina për zyre dhe perde te zyra e drejtorit dhe e zv. drejtorit , vitrina me sirtar për gjithë mësimdhënësit dhe për ditarët e mësimimit. Sh.m.l.”Dardania” është pajisur me kompjuter , tavolinë për kompjuter dhe perde te zyra e drejtorit dhe paradhomën e zyrës së drejtorit.

Të gjithë mësimdhënësit janë pajisur nga DKA-ja me fletore pune.

Janë ndarë edhe 23 bursa për studentë.

Është bërë për herë të parë dezinfektimi,dezinfektimi dhe deratizimi i shkollave në muajin gusht dmth. para fillimit të vitit shkollor 2010/11.

Shkollat me kohë janë pajisur me material shkollor(ditar,libra amë,dëftesa, libra portokolli, diploma e tj.).

Aktiviteti i nxënësve: Nxënësit e shkollave tona kanë marrë pjesë në shumë aktivitete dhe gara diturie , ku sukcesi nuk ka munguar .Ti përmendim me radhë:Dy herë radhazi kl. e V-ta të sh.f.m.u.”K. e Diturisë” në garën që e organizon MASHT-i bashkë me KOSOVISION CONTEST me temën në vizatim “Si e shohim të ardhmen e Kosovës” zë vendin e parë dhe shpërblehet me 500 lektyra ,kurse DKA-ja e shpërblen edhe me 200 lektyra tjera(hera e parë),kurse heren e dytë ende se ka marrë shpërblimin.

Më 22.04.2010 aktiviteti i gjithë nx.në -Ditën e Tokës.

Më 29.04.2010 nx. e sh.f.m.u.”V.Ballazhi” marrin pjesë në kuizin e diturisë “1,2,3 fillo” që e organizon RTK-ja.

Më 07.06.2010 grupi dramatik i sh.f.m.u. "I.Thaçi" merrë pjesë në festivalin republikan të dramës në Skenderaj,ku aktori dhe regjisor i më i mirë shpallet nga shkolla jonë.

Më 18.10.2010 në garën që e organizon MASHT-i bashk me MPB të Kosovës në esë me temën "Antitrafikimi i qenjeve njerëzore nx. e sh.m.l "Dardania" Lendita Rexha zë vendin e parë në Kosovë dhe shpërblehet , DKA-ja dhe sh.m.l."Dardania" marrin mirënjohje nga MASHT-i dhe MPBK-ës.

Nx. e sh.f.m.u. "I.Thaçi" marrën pjesë në garën që e organizon OSBE-ja në vizatim me temën "Dita e Demokracisë", katër më të mirët u shpërblen.

Gjithashtu vlenë të përmendet se vazhdimisht janë mbajtur takime me MASHT-in, janë vizituar objektet shkollore,janë furnizuar me kohë të gjitha shkollat me material të nevojshëm shkollore dhe lëndë djegëse.

Aktivitetet kulturore: DKA-ja ka ndihmuar shkollat në programet që janë mbajtur për festat shtetërore dhe shkollore.Ka ndihmuar mësimdhënësit dhe nxënësit në ndihma materiale për organizimin e ekskursioneve shkollore me karakter edukativo-arsimor.Ka organizuar programe për festat komunale dhe shtetërore në kuadër të komunës.Ka mbajtë "Javën Kulturore" prej 1 gjeri më 11.Qershor-Dita e çlirimit të Hanit të Elezit;ku në kuadër të kësaj jave janë mbajtur këto aktivitete:

-01.6.2010 Dita e fëmijëve.Fëmijët e sh.f.m.u. të komunës kanë defiluar nëpër qytet dhe kanë dhënë një program para shtëpisë së kulturës.

-02.6.2010 është mbajtë gara në kuizin e diturisë në mes sh.m.u. të komunës.

-04.6.2010 rok grupi "Ideali" dha program për qytetarët e komunës para shtëpisë së kulturës.

-09.6.2010 u mbajten garat në volejboll për femra mes ekipeve të shkollave të komunës.

- 10.6.2010 mbahet krosi në atletikë.Po këtë ditë mbahet finalja në futboll të vogël ,ku garat në futboll janë zhvilluar gjatë tërë Javës kulturore.Për më të mirët ipen shpërblime .

-11.06.2010 mbahet programi final për nder të 11.Qershorit –Ditës së çlirimit të komunës,ku edhe përfundon Java kulturore.

Më 29.8.2010 u dha një program për Ditën e Dëshmorëve të Hanit të Elezit dhe emrohet shtëpia e kulturës me emrin e dëshmorit Imri Curri.

Për çdo festë komunale dhe shtetërore është bërë stolisja e qytetit me flamuj nga puntori teknik i shtëpisë së kultures.

Në fund të vitit është bërë shpallja e sportistit dhe klubit më të mirë të komunës. Kuadri arsimor dhe sukcesi i nxënësve në fund të vitit shkollore 2009/2010 është paraqitur në tabelat e mëposhtëme

Tabela 1. Kuadri arsimor

Nr.	Shkolla	Mësimdhënës të kualifikuar		Mësimdhënës të pakualifikuar		Kualif. jo adekuat		Gjithsejtë
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
1.	Shml“Dardania”	14	73,68	2	10,52	3	15,78	19
2.	Shfmu”Ilaz Thaçi”	34	64,15	13	24,52	6	11,32	53
3.	Shfmu”K.e Diturisë”	6	50,00	3	25,00	3	25,00	12
4.	Shfmu”Veli Ballazhi”	5	41,66	7	58,33	-	-	12
Gjithsejtë		59	61,45	25	26,04	12	12,50	96

Tabela 2. Sukses i nxënësve në fund të vitit shkollor- Sh.m.l. (10-12)

Shkolla	Nr. nx.	Vij o.	Shkëlq.		Shumë mirë		Mirë		Mjaftues h.		Përsërisin		Të panot.	
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
„Dardania”	459	445	104	23.37	85	19.10	156	35.05	78	17.52	22	4.94	14	3.05

Tabela 3. Sukses i nxënësve në provimin shtetëror të maturës (SHML “Dardania”)- Afati i Qershorit

Drejtimi	Nr. Nxënësve	Suks. Pozitiv	Suks. negativ	Maks.i poenave	% kalueshm. e
Gj. Shoqëror	97	35	62	64	36
GJ. Mat.-Info.	31	12	19	65	39
Gj. Natyror	21	0	21	48	0
Gjithësejtë	149	47	102	65	32

Tabela 4. Sukses i nxënësve në provimin shtetëror të maturës (SHML “Dardania”) – Afati i Gushtit

Drejtimi	Nr. Nxënësve	Suks. Pozitiv	Suks. negativ	Maks.i poenave	% kalueshm. e
Gj. Shoqëror	64	63	1	76	98.43
GJ. Mat.-Info.	19	18	1	79	94.73
Gj. Natyror	28	28	0	74	100
Gjithësejtë	111	109	2	79	98

Tabela 5 Suksessi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2009/10 në Sh.m.l."Dardania"

Shkolla Gjimnaz	Nr.nx.	Vijojnë	Shkëlq.		Sh. Mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gj.Poz.		Përsërisin		Të pa not.	
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%		%
10	185	176	38	21.59	32	18.18	51	28.98	33	18.75	154	87.50	22	12.5	9	4.86
11	118	115	22	19.13	30	26.09	40	34.78	23	20.00	115	100.00	0	0	3	2.54
12	129	127	39	30.71	20	15.75	49	38.58	19	14.96	127	100.00	0	0	2	1.55
Gjithësejtë	432	418	99	23.68	82	19.62	140	33.49	75	17.94	396	94.74	22	5.26	14	3.24
12-Profesion.	27	27	5	18.52	3	11.11	16	59.26	3	11.11	27	100.00	0	0	0	0.00
Gjithësejtë	459	445	104	23.37	85	19.10	156	35.06	78	17.53	423	95.06	22	4.94	14	3.05

Tabela 6. Suksessi i nxënësve në fund të vitit shkollor – Arsimi fillor (I-V)

Shkolla	Nr.nx.	Shkëlq.		Sh. Mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota neg.		Të pa not.	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
"Ilaz Thaçi"	643	283	44.12	128	19.9	160	24.85	70	10.89	7	1.09	3	0.47
"K. e Diturisë"	134	71	52.84	27	20.31	26	19.56	10	7.3	0	0	0	0
"V. Ballazhi"	80	35	43.75	15	18.75	18	22.5	8	10	0	0	0	0
Gjithësejtë	857	389	45.28	170	19.79	204	23.74	88	9.42	7	0.81	3	0.34

Tabela 7 . Suksessi i nxënësve në fund të vitit shkollor – Arsimi i mesëm i ulët (VI-IX)

Shkolla	Nr.nx.	Shkëlq.		Sh. Mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Përsërisin		Të pa not.	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%		%
"Ilaz Thaçi"	512	130	25.39	112	21.88	149	29.1	112	21.88	0	0	9	76
"K. e Diturisë"	98	31	31.63	27	27.55	32	32.65	8	8.16	0	0	0	0
"V. Ballazhi"	81	20	32.09	15	18.51	23	28.39	15	18.51	0	0	2	2.46
Gjithësejtë	691	181	26.06	154	22.29	204	29.52	135	19.54	0	0	11	1.59

Krahasimi i mesatareve të notes, mungesave (të nxënësve dhe arsimtarve) mes v.sh.2008/09 dhe 2009/2010 shihet në tabelat e më poshtme:

Tabela 8 . Nota mesatar

Nr	Shkolla	Viti shkollorë		diferenca
		2008/09	2009/10	
1	Shfmu "I.Thaçi"	3.70	3.74	0.4
2	Shfmu "K.Diturisë"	3.91	3.88	-0.3
3	Shfmu "V.Ballazhi"	3.94	3.85	-0.9
4	Shml"Dardania"	3.37	3.27	-

Tabela 9. Mesatarja e mungesave për nxënës

Nr	Shkolla	Viti shkollorë		diferenca
		2008/09	2009/10	
1	Shfmu "I.Thaçi"	6.80	15.82	9.02
2	Shfmu "K.Diturisë"	14.50	14.07	-
3	Shfmu "V.Ballazhi"	10.93	12.96	2.03
4	Shml"Dardania"	10.40	31.15	20.75

Tabela 10. Mesatarja e mungesave për arsimtarë

Nr	Shkolla	Viti shkollorë		diferenca
		2008/09	2009/10	
1	Shfmu "I.Thaçi"	6.80	15.82	9.02
2	Shfmu "K.Diturisë"	14.50	14.07	-
3	Shfmu "V.Ballazhi"	10.93	12.96	2.03
4	Shml"Dardania"	10.40	31.15	20.75

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria e DSHMS-së gjatë periudhës një vjeçare, janar- dhejtor të vitit 2010 ka bërë përpjekje për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve primare shëndetësore, shërbimeve sociale dhe shërbimit të inspektimi sanitar që të jetë sa më efikas dhe cilësor. Aktiviteti i DSHMS-së ka qenë i përqëndruar në menaxhimin dhe monitorimin e punës së përditshme të stafit punues në drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në qendrën kryesore të mjekësisë familjare dhe AF. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2010 Drejtoria e DSHMS-së në bazë të planifikimit të punës gjatë këtij viti ka kryer punët e planifikuara sipas planit të punës. Drejtoria e DSHMS-së përveç QKMF-së, në vete përfshin edhe punët e shërbimit social si dhe inspektimin sanitar.

Në raportin vijues janë përmbledhur të gjitha punët e kryera në këtë drejtori:

Ka patur një bashkëpunim të ngushtë me MSH-në, IKSHPK-në, MPMS-në, MEF-në, OSBE-në, KFOR-in, SHPK-në dhe organizma të tjerë.

Ka hartuar statutin e QKMF-së duke rrespektuar procedurat, dhe në fund Asambleja Komunale ka miratuar pasi që ky statut ka patur si mbështetje ligjin e shëndetësisë.

Përveq sigurimit të barnave esenciale që janë siguruar për çdo muaj nga MSH, DSHMS-ja ka siguruar edhe një pjesë të barnave dhe mjete të punës nga buxheti komunal për QKMF-në në vlerë prej 5225 euro nga mjetet -shërbime dhe mallara. Në komunën tonë kemi patur edhe raste të personave me Hemodializë ku DSHMS-ja ka siguruar transportin për bartjen e pacientëve nga Hani Elezit për Gjilan. Në fillim kemi pasur pacient nga Hani Elezit, por që nga muaji qershor është paraqitur rast i ri nga fshati Gorancë. DSHMS-ja ka siguruar menjëherë udhëtimin e këtij pacienti. Si nevojë permanente ka qenë edhe sigurimi i oksigjenit që kjo është bërë me kohë vazhdimisht. Kjo drejtori ka realizuar disa vizita QKMF-së në Han të Elezit dhe AF Gorancë pavarësisht kohën kur që është vizituar edhe pas mesnate që nuk është vërejtur ndonjë parregullsi në punë nga punëtorët prezent. Vizitat kanë qenë të shoqëruara në disa raste edhe me Kryetarin dhe Nënkryetarin e Komunës. Nga vizitat e realizuara disa kanë pasur karakter kontrolli të gjendjes së terapisë orale dhe ampulare dhe materialeve tjera që gjenden në QKMF.

Është realizuar kontrata për analizat e ujit nga DSHPK - Ferizaj që ky institut është kujdesur për analizat kimiko-baktereologjike të ujit që sipas këtij instituti uji gjithnjë ka dalur i papijshëm.

Kemi pasur edhe një bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK që ka filluar një hulumtim për ndotjen e ambientit dhe tokës si dhe rastet e sëmundjeve nga ndotja e ajrit veçanërisht për sëmundjet e frymëmarrjes tek qytetarët. Në kuadër të këtij hulumtimi DSHMS-ja ka ofruar këtij institucioni rastet e pacientëve të cilët vuajnë nga kjo sëmundje të cilët përveq trajtimit primar shëndetësor kemi edhe raporte nga instituti i Punës në Obiliq, që si pasoj nga mbeturinat e azbestit kemi raste të sëmundjes së azbestozës. Nga IKSHK kemi kërkuar që Shërbimi ynë shëndetësor të jetë në rrjetin e SISH pasi që shumica e komunave të Kosovës janë në këtë sistem.

Nëpërmjet MSH kemi arritur që të dërgojmë në specializim një mjek, që shpresojmë dhe do të insistojmë që edhe në të ardhmen të ngriten kapacitetet profesionale të stafit QKMF-së.

Ne kuadër të DSHMS-së po pasqyrojmë edhe raportet e:

- Shërbimeve primare shëndetësore përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe AF.
- Shërbimet sociale
- Shërbimet e inspektionit sanitar

Shërbimet primare shëndetësore

QKMF-ja në Han të Elezit duke përfshirë AF-në ne fshatin Gorancë ka këtë përbërje të stafit punues

- Stomatolog – Përgjegjes	1
- Mjek te prakses se pergjithshme -	6
- Infermier	17
- Kryenifermiere	1
- Laborant	1
- Infermiere – Vaksininim	1
- Depoist- Pastrues	1
- Pastruese	1
- Shofer	1

QKMF-ja gjatë këtij viti ka qenë në shërbim të qytetarëve me orar 24 orësh, që mund të themi se mjek ka pasur rregullisht duke përfshirë edhe ditët e festave. Në çdo kohë shërbimi primar shëndetësor ju është ofruar pacientëve dhe në bazë të nevojës pacientët janë përcjellur për qendrat spitalore.

Në kuadër të QKMF-së është caktuar koordinatori i ZHVP dhe shefi i departamentit të shërbimeve shëndetësore. Është dërguar në trajnim përfaqsesi nga QKMF-ja për dhënien e Çertifikatave shëndetësore për patent shofer, është dërguar në trajnim kandidati për edukimin te vazhdueshëm infermierik.

Si problem që na është përcjell në stafin e punëtorëve ka qenë çështja e tre punëtorëve (dy pastrues dhe një shofer) si punëtorë të stafit civil të cilët nuk kanë qenë të përfshirë ne programin e pagave së bashku me stafin shëndetësor, por program në vete. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi tek punëtorët me rastin e ngritjeve të ardhurave personale. Edhe ky problem ka përfunduar ne dobi të punëtorëve ne fund te vitit kalendarik. Ministria e Financave ka pranuar që tre punëtorët të përfshihen ne listat e pagave si punëtor shëndetësor e jo si staf civil.

Objekti i QKMF-së dhe ai i AF ne fshatin Gorancë janë të mirëmbajtura nga ana higjienike.

Ky vendim ka rezultuar pozitivisht në kontrollin e materialit për nevojat e QKMF-së si për medikamente ashtu edhe materiale tjera. Është bërë me kohë sigurimi i derivateve për ngrohje të QKMF-së dhe AF Gorancë. Gjithashtu janë kryer servisimet e aparaturave me të cilat disponon QKMF-ja.

Synim i drejtorisë ka qenë edhe sigurimi i autoambulancës për bartjen e pacientëve për në qendra spitalore, që edhe kjo është realizuar nga donacioni i

Irlandes së Veriut „Kosova support group” qe nga muaji Qershor. Përveç këtij donacioni kemi edhe donatorin tjetër nga Autosalloni “Kosova Limo” nga Ferizaj i cili ka dhuruar nje autoveturë të tipit mercedes. Është bërë pajisja e autoveturave me mjete dimri si goma,zingjir dhe antifriz. Është bërë edhe rregullimi i ujësjellsit që QKMF-ja nuk ka pasur mungesë të ujit asnjëherë.

Me rekomandimi e Drejtorit SHMS Zyrtari i larte i shëndetësisë ka bërë edhe vizitë QKMF-së ,procedurat e dokumentacionit për pushime të lehonisë, pushimet vjetore, vazhdimin e kontratave punëtorëve , ka proceduar edhe kontratat ne vepër punëtorëve vlerësimin e ofertave për material të QKMF-së. Probleme të cilat na kanë përcjell kan qenë: ndërprerjet e punës së mjekëve ku kjo ka ndikuar edhe në ngarkesë me punë mjekëve prezent, vetëm që QKMF-ja mos te mbetet pa mjek brenda 24 orëve.

Në fund të vitit kalendarik nga QKMF-ja kemi pranuar perfomancat e punëtorëve dhe raportin e punës për vitin kalëndarik 2010 ku edhe po e prezentojme në formë tabelare.

RAPORT VJETOR PER KONTROLLIMET MJEKSORE PER VITIN 2010

Muaji	Totali	Diagnozat para e	perseritur	0-6 vjet	6-15 vite	15 vite e me shume	Me participim	pa participim	Refe. speci spitali	EKG dhe Inhalimet	Me participim	pa participim
Janar	1853	1547	306	293	379	1181	186	1667	142	16		16
Shkurt	1711	1416	295	257	362	1092	161	1550	121	10		10
Mars	1988	1741	247	282	462	1244	165	1823	121	41		41
Prill	1842	1529	313	254	416	1172	207	1635	114	76		76
Maj	1852	1500	352	302	351	1199	196	1656	158	50	42	8
Qershor	1896	1457	439	313	383	1200	165	1731	154	43	2	41
Korrik	2223	1686	537	445	374	1404	252	1972	160	56		56
Gusht	2344	1905	439	401	437	1506	297	247	121	47		47
Shtator	2051	1628	423	327	454	1270	238	1813	105	21	2	19
Tetor	2073	1594	479	325	527	1221	201	1877	135	32		32
Nentor	2271	1864	407	271	453	1547	222	2049	161	53	5	48
Dhjetor	2420	2249	171	374	671	1375	182	2238	151	33		33
GJITHË.	24524	20116	4408	3844	5269	15411	2472	20258	1643	478	51	427

RAPORTI VJETOR PER INTERVENIMIT PER VITIN 2010

Muaji	Totali	0-6 vjet	6-15 vite	15 vite e me shume	Me participim	Pa participim	T dhe lidhje	Me participim	pa participim
Janar	1072	47	36	989	152	920	92	2	90
Shkurt	926	38	60	828	122	804	60	5	55
mars	1204	118	56	1030	129	1075	106	3	103
Prill	1180	91	79	1010	177	1003	108	7	101
Maj	1141	116	82	943	151	990	280	5	275
qershor	927	100	104	723	125	802	163	2	161
Korrik	1387	155	104	1128	212	1175	113	6	107
gusht	1361	112	97	1152	235	1126	138	9	129
Shtator	1116	76	95	945	194	922	103	8	95
Tetor	1209	90	98	1021	179	1030	260	10	250
Nentor	1244	115	65	1064	174	1070	125	6	119
Dhjetor	1321	150	164	1007	124	1197	148	8	140
1-12	14088	1208	1040	11840	1762	12114	1696	71	1625

RAPORTI

VJETOR PER LABORATOR PER VITIN 2010

Muaji	Biokimia	Hematologjia	Urina	Totali
Janar	45	91	72	208
Shkurt	45	117	75	237
mars	47	115	63	225
Prill	57	109	103	269
Maj	87	108	93	288
qershor	61	96	69	226
Korrik	105	126	101	332
gusht	80	130	102	312
Shtator	14	16	13	43
Tetor	76	128	108	312
Nentor	96	140	121	357
Dhjetor	82	138	106	326
1-12	795	1314	1026	3135

RAPORTI VJETOR I STOMATOLOGUT

Muaji	Totali	0-6 vjet	6-15 vjet	15 vite e me shumë	Me participim	Pa participim	Dhëmbë të nxjerrë	Intev. Të tjera
Janar	198	24	89	85	10	188	91	37
Shkurt	271	35	145	91	6	265	132	523
Mars	272	52	127	93	6	266	125	481
Prill	119	19	54	46	4	115	59	216
Maj	231	31	91	109	15	216	113	438
Qershor	257	44	106	107	6	251	113	450
Korrik	219	44	79	96	12	207	109	426
Gusht	74	18	20	36	2	72	33	148
Shtator	136	24	59	53	5	131	64	246
Tetor	262	34	141	87	11	251	120	491
Nentor	228	28	116	84	14	214	103	435
Dhjetor	209	14	116	79	5	204	106	381
TOTALI	2476	367	1143	966	96	2380	1168	4272

Raport mbi punën e inspektorit Sanitar

Gjatë kësaj periudhe është bërë inspektimi i rregullt i subjekteve afariste, objekteve parashkollore, shkollore, QKMF-së, ordinancave private, salloneve të ondulimit, restauranteve, ndotësve të ambientit etj. Janë bërë vërejtje të ndryshme, urdhëresa, aktvendime, si dhe gjoba mandatare aty ku është parë nevoja.

Në bazë të raportit të inspektores sanitare për këtë vit janë bërë **60** inspektime ne lokalet te ndryshme. Nga këto inspektime janë vërejtur artikuj me afat të skaduar në vlerë prej **6998 euro**.

Nga inspektorja sanitare janë dhënë edhe vërejtje subjekteve afariste me qëllim të vetëdijesimit të tyre mbi kujdesin e veçantë të artikujve ushqimor .

Hap i marrun nga inspektorja sanitare ka qenë edhe largimi i artikujve ushqimor të ekspozuar jashtë lokalit ku nuk i përshtaten kushteve e sidomos në stinën e verës ku temperaturat janë mjaft të larta . Nga ISHP janë bërë analizat e ujit dhe atë: kimike dhe bakteriologjike ku në te gjitha rastet uji i qytetit është i pa pijshëm.

Veprimtaria-	Nr.	Subjektet afariste
Pranime sanitare-teknike mbi plotsimin e kushteve higjeno-sanitare	60	
Inspektimi i ordinancave private shëndetësore	4	
Inspektimi i ujrave të pijshëm DSHPA	54	
Inspektimi i ujrave të zeza	9	
Mostra të ushqimit të dërguara për analizë	0	
Procesverbale të lëshuara gjatë inspektimit	149	
Aktvendime	20	
Urdhëresa	6	
Kërkesa të ndryshme	2	
Libreza sanitare- puntorët që merren me shitjen dhe prodh.e artikujve ushqimor që kanë të kryer kontrollin shëndetësor	50%	
Inspektimet të tregut	32	
Asgjësimit të mallit-artikuj me afat të skaduar që janë larguar nga shitja dhe janë asgjësuar	6998 Euro	
Mbyllje të lokalit	1	
Inspektime të objekteve edukativo-arsimore	6	
Inspektime të barnatoreve farmaceutike	6	
Inspektime i saloneve të ondulimit	4	
Urdhëresa për klorizim të ujit të pijshëm	1	
Inspëktime së bashku me inspektorin e tregut	60	
Dënimet madatave që janë bërë gjatë inspektimit	8	300 Euro
Njoftime	4	
Inspektime pa procesverbal	43	
Pjesëmarrja në trajnime	4	

Qendra për Punë Sociale

Kjo qendër aktivitetin e vet e ka zhvilluar në:

Çështjen Sociale dhe Asistencën Sociale.

Çështjen sociale në vete përfshinë: rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj, fëmijët e mitur me strehim familjar (fëmijët pa prindër), fëmijët e mitur që kanë kryer vepra kundërvajtëse, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe marrjen e pëlqimit për shtetësi të fëmijëve.

Gjatë vitit 2010 nga Policia e Kosovës kemi pasur të referuara në QPS 4 raste dhune në familje, 8 raste fëmijë të mitur me strehim familjar, 11 raste me aftësi të kufizuara dhe marrje e 9 pëlqimeve për shtetësi.

Në asistencë sociale gjatë vitit kemi pasur mesatarisht nga 196 raste. (numëri i tyre ndryshon nga muaji në muaj)

I PLANIFIKIMI

1.Hartimi i planit zhvillimor Komunal (PZHK-së): -Sektori i Urbanizmit së bashku me Drejtoritë e tjera në nivel Komune, me asistimin teknik të UN-HABITAT-it, intenzivisht ka punuar në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Hartimi i këtij dokumenti po realizohet në bazë të agjendës të përcaktuar nga grupi planifikues dhe në harmoni të plotë me dispozitat e ligjit për planifikim hapsinor 2003/14.

Përndryshe, deri më tani janë përfunduar të gjitha kapitujt e PZHK-së dhe se i njejtë nga data 17.12.2010 është në diskutim publik për dy muaj, pra deri më 17.02.2011.

Në funksion të hartimit të PZHK-së janë mbajtur edhe dy puntori të vizionimit si dhe janë bërë edhe dy prezentime (debate) publike.

2.Hartimi i Planit zhvillimor Urban: -Në fillim të muajit Gusht, me vendim të Kuvendit Komunal dhe në bazë të Ligjit mbi Planifikimin Hapsinor 2003/14, ka filluar hartimi i Planit Zhvillimor Urban.

Edhe ky plan po hartohet me mbështetje teknike të UN-HABITAT-it, finacuar nga SIDA. Deri më tani ka përfunduar hartimi i profilit (analiza e gjendjes ekzistuese) dhe po punohet kapitulli i dytë i planit: vizioni, parimet dhe caqet.

II PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Sektori i Urbanizmit në vazhdimësi ka qenë i angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale përmes:

- Ofrimit të dokumentacionit (fletave poseduese, kopjet e planit, ortofotot, koordinatat, kushtet e lokacionit, kushtet urbanistike etj) projektuesve të projekteve investive kapitale.
- Përgatitjes së paramasave dhe paralogarive nga sektori jonë për projektet parësore në këtë periudhë siç janë: Aneksi i shkollës fillore në Paldenicë, sistemi i kanalizimit në Seçishtë, rrugicat, trotualet në Han të Elezit etj.
- Përcjellja e punimeve në teren dhe ndihma punëkryesit në realizimin e projekteve.

Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale si dhe statusin e tyre momental:

LISTA E PROJEKTEVE INVESTIVE KAPITALE

#	EMRI I PROJEKTIT	DONATORI DHE ADRESA	BUXHETI	STATUSI I MOMENTAL I PROJEKTIT	KOHËZGJATJA
1	Kanalizimi fekal i fshatit Paldenicë	Ministria e Pushtetit Lokal	135,523 €	Ka përfunduar	Viti 2010
	Segmentet e kanalizimit të fshatit Paldenicë – Hani i Elezit	K.K. Hani i Elezit	38,767.60 €	Ka përfunduar	Viti 2010
2	Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Paldenicë	Komisioni Evropian	570,000 €	Në fazën e realizimit	Viti 2010
3	Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Gorancë	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	2,348,816 €	Në fazën e realizimit	Viti 2010-2011
4	Rrethoja e shkollës fillore në fshatin Seçishtë dhe furnizimi me inventar	USAID	45,000 \$	Ka përfunduar	Viti 2009-2010
5	Rregullimi i burimit të ujësellsit të fsh. Gorancë	CARITAS - Luksemburg	17,000 €	Ka përfunduar	Viti 2009-2010
		K.K. Hani i Elezit	1,500 €		
6	Ujësjellësi i Dimcës	CDI - Zvicërr	229,000 €	Ka përfunduar	Viti 2009-2010
		SHARR CEM - H.Elezit	30,000 €		
		K.K. Hani i Elezit	178,000 €		
		Gjithsej:	437,000 €		
7	Rregullimi i sheshit të qytetit	K.K. Hani i Elezit	30,587.50 €	Në fazën e realizimit	Viti 2010-2011
		UN - HABITAT	30,587.50 €		
		Gjithsej:	61.175 €		
8	Pajisja e KK Hani i Elezit me inventar	USAID	45,000 \$	Në fazën e realizimit	Viti 2010
9	Palestra sportive	Komisioni Evropian	300-400,000€	Ka përfunduar faza e tenderimit	Viti 2010-2011
10	Aneksi i shkollës fillore në fshatin Paldenicë	CARITAS	20,000 €	Ka përfunduar	Viti 2010
		K.K. Hani i Elezit	21,000 €		
		Komuniteti	20,000 €		
		Gjithsej:	61,000 €		

11	Kanalizimi i fshatit Seçishtë	K.K. Hani i Elezit	17,127 €	Ka përfunduar	Viti 2010
12	Asfaltimi i Rrugës Kotlinë-Laç, dhe Lagja e Re	K.K. Hani i Elezit	17,000 €	Ka përfunduar	Viti 2010
13	Shtrimi me kubëza betoni i rrugës së tregut.	LOGOS-Zvicërr	9,000 €	Ka përfunduar	Viti 2010
		K.K. Hani i Elezit	3,280 €		
		Gjithesj:	12,280 €		
14	Rregullimi i rrugicave me kubëza betoni në qytetin e Hanit të Elezit (2000m ²)	K.K. Hani i Elezit	45,314.28 €	Ka përfunduar	Viti 2010
15	Shkallet emergjente të shkollës fillore "Ilaz Thaçi" Hani ë Elezit		15,538.10 €	Ka përfunduar	Viti 2010

III KËRKESAT E QYTETARËVE – PERSONAVE FIZIK DHE JURIDIK NDAJ DREJTORISË

Gjatë vitit 2010 Drejtorisë i janë bërë 62 kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kërkesa për lejendërtim, ndërrim të destinacionit, shfrytëzim të pasurisë komunale etj.

Nga numri i lartpërmendur i kërkesave:

- 36 kërkesa janë miratuar
- 11 janë refuzuar si të pabaza
- 4 kërkesa janë dhënë informacione shtesë
- 4 kërkesa janë në shqyrtim e sipër
- 7 kërkesa janë të pezulluara

Gjatë kësaj periudhe drejtorja ka paraqitur:

- 2 kërkesa MAPL-së për ndryshim të trasesë të një segmenti të kanalizimit në fshatin Paldenicë si dhe një njoftim,
- 1 kërkesë MMPH, për pastrimin e lumit Lepenc,
- 6 kërkesa AKK-së për instalimin sa më të shpejt të kadastrit, regjistrimit të dokumentacionit kadastral dhe kërkesë për ndihmë teknike dhe profesionale,
- 1 kërkesë KEK-ut për kyçje në rrjetin elektrik (pëlqim) për sallën sportive,
- 1 kërkesë PTK-së për zhvendosjen e agregatit nga pozita e tanishme,
- 1 kërkesë Drejtorisë së Kadastrit – Kaçanik,
- 1 kërkesë Arkivit të Kuvendit Komunal Kaçanik për marrjen e dokumentacionit ekzistues për banesat në pronësi shoqërore.
- 1 kërkesë ProCredit Bank – Prishtinë, për bashkëfinancim në projektin “Rregullimi i Hapsirave Publike”

Po ashtu gjatë kësaj periudhe Drejtoria ka lëshuar:

- 13 leje ndërtimi,
- 4 Aktvendime,
- 7 pëlqime,
- 1 vërtetim,
- 8 procesverbale ndërtuesve pa leje ndërtimi,
- 3 procesverbale për ndotje të ambientit,
- 2 denime mandatore për ndotje të ambientit,
- 4 urdhëresa nga inspektori i ndërtimit për ndërprerjen e menjëhershme të punimeve pa leje ndërtimi,
- 32 ftesa shfrytëzuesve të pasurisë Komunale për shprehje të interesit,
- 32 renovime të kontratave për shfrytëzim të pronave komunale etj.

IV NDËRTIMET ME DHE PA LEJE NË HAN TË ELEZIT

Gjatë vitit 2010, në Han të Elezit si ndërtime të reja kanë nisur 20 objekte (shtëpi familjare, objekte banesore-afariste) dhe se vetëm 9 prej tyre kanë nisur me leje ndërtimi. Pas intervenimit të inspektorit të ndërtimeve për marrje të lejes së ndërtimit kanë aplikuar edhe 7 ndërtues të tjerë prej të cilëve 4 ndërtues vetëm janë pajisur me leje, 3 të tjerë janë në procedura të pajisjes. Ndërkaq 4 ndërtues nuk i janë përgjigjur urdhëresës së inspektorit për pajisje me leje dhe ndaj tyre do të zhvillohen procedurat e parapara me ligjin mbi ndërtimet.

V SHFRYTËZIMI I TOKËS NDËRTIMORE PRONË E KUVENDIT KOMUNAL

Në Han të Elezit janë 31 shfrytëzues të tokës ndërtimore pronë e Kuvendit Komunal, ku janë të vendosura lokalet me karakter të përkohshëm dhe një shfrytëzues lokal i shtëpia e të vetmuarve. Sipërfaqja e përgjithshme është 928 m² ndërkaq taksa e përgjithshme vjetore të cilën duhet ta paguajnë shfrytëzuesit me kontratë është 5913€ Vitin 2010, Drejtoria ka inkasuar 5078.64€ ose 86% të shumës së përgjithshme. Ndërkaq vitin 2009, Drejtoria e Urbanizmit ka inkasuar vetëm 986,36€ ose 15.8% të taksës së përgjithshme vjetore. Në raport me vitin 2009, këtë vit të hyrat nga inkasimi i taksës janë rritur për 415%.

VI KADASTRI

Një nga prioritetet kryesore të Drejtorisë për vitin 2010 ka qenë funksionalizimi i plotë i sektorit të Kadastrit. Në rrugën e përbushjes së këtij prioriteti, Drejtoria me ndihmën e Kryetarit të Komunës ka përbushur këto detyra:

- Ka vënë kontakte bashkpunimi me Agjensionin Kosovar të Kadastrit me qëllim të funksionalizimit të Kadastrit në Komunën tone,
- Janë caktuar me kohë zyrtarët të cilët do të punojnë në sektorin e Kadastrit,

- Është bërë ri-rregullimi i zyrës së Kadastrit dhe është pajisur me mjetet e nevojshme për punë,
- Në muajin Maj me pëlqimin e AKK-së është bërë regjistrimi i tërë dokumentacionit Kadastral për gjitha zonat Kadastrale të Komunës,
- Janë mbajtur trajnime dhjetëditore në AKK, për zyrtarët tonë,
- Dhe së fundit me datën 30.06.2010 është nënshkruar marrëveshja mes Komunës sonë dhe Komunës së Kaçanikut për transferimin e tërë dokumentacionit Kadastral në Komunën tonë, me çka nga kjo datë sektori i Kadastrit është bërë funksional dhe se të tëra shërbimet Kadastrale nga kjo datë merren pranë këtij sektori.

Gjatë kësaj periudhe sektori i kadastrit ka shqyrtuar 485 kërkesa prej të cilave:

- 40 kërkesa për bartje të pronës
- 7 kërkesa për hipoteka
- 12 kërkesa për ndarje të parcelave
- 8 kërkesa për çertifikata për viza
- 52 kërkesa për çertifikata për pronat e paluajtshme
- 82 kërkesa për çertifikata të socialit
- 9 kërkesa për çertifikata që nuk posedon paluajtshmëri
- 108 kërkesa për fleta poseduese
- 1 kërkesë për historiat të parcelës
- 1 kërkesë për identifikim të parcelës në teren
- 1 kërkesë për identifikim të parcelës në zyre
- 1 kërkesë për identifikim
- 13 kërkesa për ndarje fizike
- 1 kërkesë për regjistrim të pronës
- 5 kërkesa për kopje plani vertikale A0, 1:2500
- 3 kërkesa për kopje plani A3
- 102 kërkesa për kopje plani A4
- 39 kërkesa për kopje plani A4-A0 dhe
- 488 pika të parcelave.

Gjatë periudhës së lartpërmendur sektori i Kadastrit ka realizuar të hyra në shumë prej: 5770 €

VII MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e Mbrojtjes së Mjedisit:

- Është miratuar rregullorja Komonale mbi Mbrojtjen e Mjedisit,
- Është vëzhguar në vazhdimsi “SHARR CEM-i” ku pas çdo ndotje nga kjo kompani është reaguar me vërejtje dhe njoftim të MMPH-së poashtu nga kjo kompani është kërkuar vendosja e filtrave mekanik si dhe instalimi i pajisjeve monitoruese vetanake dhe për raportet e matjeve të njoftohen zyrtarët kompetent Komunal,

- Në bashkëpunim me inspektorët e Ministrisë së Mjedisit janë mbajtur kontakte të rregullta dhe janë bërë inspektime të përbashkëta të ndotjes,
- Është shënuar me një aksion gjithëpërfshirës pastrimi - dita ndërkombëtare e TOKËS, 22 Prilli, etj.

VIII TË HYRAT E DREJTORISË SË URBANIZIMIT, KADASTRIT, DHE MBROJTJES SË MJEDISIT për vitin 2010.

Vitin raportues Drejtoria ka realizuar të hyra në shumë prej 25,756.64 €

#	Të Hyrat për tërë vitin 2010	
1	Nga taksat për leje ndërtimi.	9,698.94 €
2	Nga shërbimet kadastrale.	5,770.00 €
3	Nga taksat për shfrytëzimin e tokës ndërtimore pronë e K.K. Hani i Elezit.	5,078.64 €
4	Nga Panot reklamuese.	3,600.00 €
5	Nga dhënja e pëlqimeve të ndryshme.	90.00 €
6	Të hyrat tjera.	1,519.06 €
~	Gjithsej:	25,756.64 €

Në raport me vitin 2009, të hyrat e Drejtorisë vitin 2010 kanë shënuar rritje për 48.2%.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emërgjencë

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka punuar në sistemimin dhe rregullimin defekteve të ujësjellësit i cili ka pasur shumë probleme gjatë viteve të me hershme. Jemi munduar që qytetaret të kenë me shumë ujë nga sistemi i ujësjellësit, që vite me radhe ka pasur mjaftë probleme me furnizim të ujit.

- a) Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 është bërë e mundur që ujësjellësi i ri i Dimces të arrij në fazën finale- përfundimtare të instalimit të gjithë mekanizmave dhe aparaturës për filtrimin e ujit.
- b) Në Tetor-Nëntor kemi rregulluar defektin e ujësjellësit në Glloboqicë.

Problemet e sistemeve të ujësjellësit në Han të Elezit

Me lëshimin pompave për filtrimin e ujit kemi vërejtë se kemi humbje të mëdha të ujit. Kemi filluar me ç'kyçje të gypave të vjetër. Me ndihmën e CDI-së zvicerane e cila ishte edhe donator në ndërtimin fabrikës së ujit në Dimcë kemi arritur që të bëjmë zvogëlimin e humbjeve të cilat i kishim më herët. Mirëpo duke pas parasysh se në qytetin e Hanit të Elezit ekzistojnë dy rrjeta të ujësjellësve; njeri nga ujësjellësi i vjetër i asbest-çimentos dhe tjetri nga gypat e ri, humbjet ishin të mëdha për arsye të qarkullimit të ujit nëpër dy gypat dhe ndoshta edhe rrjedhjen e tij në ndonjë vend ende i pa njohur për ne. Aparatura e cila është vendosur në ujësjellësin e ri të Dimces është aparaturë moderne me standarde të Bashkimit Evropian me filtrim të ujit për 20 l/s. Që nga fillimi i testeve të ujësjellësit të ri të Dimces vërejtëm se ky kapacitet i ujit i cili filtrohet është i pa mundur që të furnizoj qytetin Hanit të Elezit, po ashtu qytetareve në pjesën e epërme të qytetit nga lagjja "Imri Curri" e më lartë nuk furnizoheshin me uji andaj ishte edhe kërkesë e qytetarëve por edhe nga udhëheqja Komunale që të lëshohet uji pa filtrim që do të thotë jo i pijshëm, për furnizim të vazhdueshëm me ujë për qytetin ashtu si ka qenë viteve të më pashme. Humbjet në këtë rrjet të ujësjellësit nga konstatimet tona janë qarkullimi i ujit nga rrjeti e ri në rrjetin e vjetër të ujësjellësit por duke mos përjashtuar edhe faktorin njeri që do të thotë keqpërdorimi i ujit.

Si problematikë vlenë të theksohet edhe mbyllja (bllokimi) i gypit në Glloboqicë gyp i nxënë në qershor të 2010. Ne si drejtori kemi marrë me urgjence për rregullimin e këtij defekti të shkaktuar. Drejtoria e DSHPE-së ka konstatuar se problemi i ndaljes së ujit është nxënia apo bllokimi i gypit me rrënjë të barishteve dhe dëmtimi i gypit nga peshat. Me të ndërruar gypin me largësi 512 m (metra) sasia e ujit është shtuar edhe për më shumë se sa ishte edhe vitin e kaluar. Mirëpo vlen të ceket se në kushte klimatike të nxehta mundet të zvogëlohet sasia e ujit të Glloboqicës po ashtu duke pas parasysh edhe faktorin njeri i cili benë keqpërdorimin e ujit të pijshëm.

ELEMINIMI I DEFEKTEVE NE UJESJELLËS

Ne si Drejtori jemi munduar të rregullojmë apo eliminojmë defekte që kanë ndodhur në ujësjellësit e Hanit të Elezit. Numri i defekteve të eliminuara në ujësjellësit e Hanit të Elezit arrin në numrin 42 këtu duke i përfshire edhe eliminimin e defekteve në Fushën e Seçishtës dhe në lagjen Meliq.

Po ashtu kemi bërë 3 herë edhe pastrimin e kanalizimit atmosferik gjatë këtij viti, duke mos harruar edhe atë të kanalizimit fekal.

Inspektimet

Drejtorja e Shërbimeve Publike me inspektorin e Komunës së Hanit të Elezit ka bërë inspektime prej të cilave do të përmendim:

Inspektimin e fabrikës së Sharr-Cem-it, ku ne kemi inspektuar për arsye të ndotjes së ambientit nga derdhjet e lëndës së Mazutit në prrockën e Dimcës, lëndë nga e cila është ndotur ambienti deri tek lumi Lepenc dhe se janë marre masat paraprake të parapara me ligj, nga inspektorët Komunal.

Kërkesat e personave fizik-juridik në drejtorinë e DSHPE-së

Në gjashtëmujorin e parë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë Civile janë bërë 47 kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me leje për kyçje në sistemin ujësjellës.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 gjithsej kanë qenë 31 kërkesa po ashtu edhe këto kërkesa kanë të bëjnë me leje për kyçje në sistemin e ujësjellës dhe një kërkesë për leje të prerjes së asfaltit. Numri i i përgjithshëm i kërkesave për vitin 2010 është 78.

- Kërkesa të miratuara janë 73
- Kërkesat jo të miratuara- të refuzuara janë 5.

TE HYRAT NGA DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Të hyrat nga ujësjellësi në drejtorinë e Shërbimeve Publike kanë bërë që të gjitha duke paguar shumën e caktuar prej 50 € (pesëdhjetë euro) për kyçje në sistemin e ujësjellës të Dimcës dhe atë të Glloboqices.

Të hyrat në Drejtorinë DSHPE-së janë : 2,180 €

SHERBIMI I ZJARRFIKESVE –SHZSH-

Shërbimi i zjarrfikësve të Hanit të Elezit gjate vitit 2010 ka lokalizuar 24 zjarre të cilat kanë përfshirë pjesë të ndryshme të qytetit tonë dhe fshatrave për rreth.

Në rastet kur shërbimi i zjarrfikësve ka intervenuar për të lokalizuar zjarre, zjarret e përhapura kanë qenë zjarre kryesisht të shkaktuara nga rryma elektrike dhe nga faktori njeri.

Po ashtu kemi pasur edhe disa ushtrime në teren, prej të cilave ushtrime në teren është ai në fshatin Seçishte në një pjese malore, ushtrimet në fshatin Gorance dhe ushtrimet tek varrezat e dëshmoreve në fshatin Puset e Nikes.

Vlen të theksohet edhe intervenimi i shërbimit të zjarrfikësve që u ka ofruar qytetareve për disa herë nga rritjet e ujit në përroin e Rezhances, po ashtu kanë ndihmuar në pastrimin e kanalizimeve me anë të autocisternës.

Vlenë të theksohet se në të shumtën e intervenimeve zjarrfikësve të Hanit të Elezit i kanë dalur në ndihmë zjarrfiksat e Kaçanikut dhe ato të ndërmarrjes Sharr-sallonit dhe Sharr-cem për shkak të defekteve në kamionin e zjarrfikësve të Hanit të Elezit

Udhëheqësja e Personelit

Më 01.04.2010 për herë të parë është hapur pozita e Udhëheqësit të Personelit në komunën tonë, fillimisht duke ditur që më heret kjo pozitë nuk ka ekzistuar dhe administrata Komonale nuk ka pasur një Udhëheqës të Personelit, me dosjet personale të personelit të komunës ka menaxhuar Drejtori i Administratës deri në momentin e rekrutimit të Udhëheqëses së Personelit.

Më pastaj dosjet e Personelit nga zyra e Drejtorit të Administratës kanë kaluar në zyrën e Personelit, ku edhe fillimisht Udhëheqësja e Personelit është marrë me sistemimin dhe kompletimin dosjeve, më duhet të theksoj se dosjet nuk kanë qenë të kompletuara dhe kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së Udhëheqësit të Personelit, me ç'rast edhe raporti i Auditimit të vitit 2009 ka konstatuar se ka mungesa të shumta në dosjet personale konfidenciale.

Gjithsesi tani pas një pune relativisht të gjatë dhe në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive kemi arritur që 80% e dosjeve të jenë të kompletuara dhe përmbajnë të gjitha dokumentet që kërkohen me Procedurën e kompletimit të dosjeve, e them këtë për arsye se nga vizita e Auditorëve të jashtëm që e kemi pasur në muajin Tetor të vitit 2010, është konkluduar që në krahasim me vitin paraprak është arritur bukur shumë që në dosje Personale të mos mungojnë dokumentet kyçe dhe ata që kërkohen me procedur.

Vlen të theksohet se zyra e Personelit ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me nivelin qendrorë e me theks të veçantë me Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC) i cili është në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Në këtë shërbim që zhvillohen të gjitha procedurat e menaxhimit të personelit duke filluar prej procedurës së rekrutimit e deri te ajo e ndërprerjes së mardhënies së punës, është punuar duke u bazuar në rregulloren Nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil dhe

Urdhëresën Administrative Nr.2003/2 si zbatim i rregullores Nr.2001/36 si dhe të gjitha udhëzimeve të posaqme të procedurave të menaxhimit të personelit, në muajin korrik të këtij viti ka hyrë në fuqi edhe Ligji i ri i Shërbyesve Civil, i cili e rregullon më mire statusin e shërbyesve civil , mirëpo ky ligj nuk zbatohet ende plotësisht për arsye se mungojnë aktet tjera nënligjore të cilat e bëjnë më të kompletuar ligjin, megjithatë me të filluar vitin 2011 ashtu siq na është thënë nga niveli qendror, do të nxirren të gjitha rregulloret për kompletim të ligjit dhe ky ligj do të filloj të zbatohet tërësisht mbrenda këtij viti.

- **Punëtorë të pranuar në punë gjatë 2010 gjithsej 6** (3 punëtorë në Drejtorin e Urbanizmit dhe Kadastrit, 2 në Drejtorin e Administratës dhe 1 punëtorë në zyrën e Kryetarit)
- **Punëtorë që kanë pasur ndryshime të koeficientit gjithsej 8** (3 punëtorë në zyrën e Kryetarit, 3 punëtorë në Drejtorin e Administratës dhe 2 punëtorë në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave)
- **Punëtorë që kanë pasur lëvizje të vendit të punës gjithsej 3** (2 nga Drejtoria e Administratës kanë kaluar në Zyrën e Kryetarit dhe 1 në Drejtorinë e Urbanizmit)
- **Punëtorë të larguar me vetëdëshirë nga Shërbimi civil Komunal vetëm 1** (në Drejtorin e Arsimit dhe Kulturës)

Gjithashtu pas vendosjes së sistemit digjital të evidences është ndërprerë forma e nënshkrimeve për sa i përket prezences në punë, të gjithë punëtorët janë pajisur me pulla elektronike, dhe përcjellja e evidencës bëhet nëpërmjet sistemit digjital.

Duke pasur parasysh se një ndër procedurat tjera të menaxhimit të personelit është procedura Disiplinore, pas marrjes së vendimit për respektimin e orarit të punës me nr 02/270/2010 nga Kryetari i Komunës kjo procedure ka gjetur zbatim ndaj shërbyesve civil.

Zyra e transparencës

Në përputhje me Rregulloren e Transparencës e miratuar nga Kuvendi i Komunës si dhe planin e aprovuar të veprimit për vitin 2010 , zyra e transparencës gjatë vitit 2010 aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit sa më të mirë si të qytetarëve të komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kishin të bëjnë me zhvillimet në komunën tonë.

Në vazhden e aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime zyra për transparencë ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për transparencë , duke organizuar katër debate publike tematike,në të cilën janë debatuar rregullore të dala nga Kuvendi i Komunës për diskutime publike ,ka realizuar tre takime të Kryetarit të Komunës me qytetarët, dy dëgjime publike për

planifikimet buxhetore si dhe dy debate publike në bashkëpunim me zyrën UN-HABITAT-it për afirmimin e „Planit zhvillimor komunal”.Duhet të theksohet se në të gjitha këto tubime pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme duke iu mundësuar qytetarëve të jenë të informuar me kohë për të gjitha zhvillimet në komunë në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë e këtyre zhvillimeve.

Në raportin e progresit të zyrës së OSBE-së për vitin 2009 për komunat Hani i Elezit „Junik dhe Mamushë komuna e Hanit të Elezit është vlerësuar si me e suksesshme në fushën e transparencës ,dhe me 05.05.2010 ka qenë nikoqire e punëtorisë „Zbatimi i praktikave më të mira ne fushën e transparencës në Komuna”, për komunat Junik dhe Mamushë dhe si vlerësim i mirë i këtyre praktikave ,me ftesë të OSBE-së dhe MAPL-së, me 03.06.2010 zyra për transparencë këto praktika i ka prezantuar edhe para zyrave për informim të rajonit të Prishtinës.

Në mënyrë që para qytetarëve të komunës dhe opinionit më të gjerë të paraqet zhvillimet,sfidat dhe të arriturat në komunën tonë ,zyra për transparencë ka marrë një sërë aktivitete duke përdorur të gjitha format e komunikimit,faqen zyrtare të Komunës,njoftimet publike,shpalljet publike, shtypin ditore dhe atë elektronikë ndërsa në bashkëpunim me UN-HABITAT-in edhe dy fletushka informative .

Faqja zyrtare e Komunës <http://kk.rks-gov.net/hanielezit/> tashmë paraqet një hyrje te re në fushën e informimit dhe komunikimit masiv dhe kjo më së miri dëshmohet me numrin e vizitave .Që nga promovimi zyrtarë në fund të muajit Maj e deri në fund te vitit 2010 ka pasur afro 4500 vizitorë,me një shtrirje të mirë ndërkombëtare dhe kompatible me të gjitha llojet e shfletuesve modern të internetit.

Sigurisht se e veçanta e kësaj Faqe, është se kjo nuk është vetëm një gazetë elektronike por paraqet edhe një mekanizëm shumë funksional në dorën e të gjithë qytetarëve për të komunikuar me institucionin e komunës, por edhe së shpejti për të kryer edhe shumë shërbime të dobishme edhe për qytetarët. Jemi shumë optimistë se Komuna e jonë është tashmë gati në aspektin teknologjik të përcjell aplikacionet më moderne në fushën e shërbimeve on-line për qytetarët.

Përkundë konkurrencës së madhe në tregun informativ zyra e transparencës ia ka arritur që zhvillimet në Komunë tonë ti paraqes me mbi 70 shkrime dhe publikime informative në gati të gjitha gazetate ditore ,intervista individuale të Kryetarit të Komunës si në shtypin ditore ashtu edhe në atë elektronike,duke përfshirë të gjitha Televizionet dhe Radiot Nacionale, si dhe kemi arritur që të realizojmë edhe tri konferenca tematike për shtyp;

- Të arriturat dhe planifikimet e komunës për vitin 2010 - Qershor
- Problemet me ndotjen e ambientit në Hanë të Elezit -Nëntor
- Të arriturat për vitin 2010 si dhe sfidat dhe planifikimet për vitin 2011-Dhjetor

Sigurisht se Reagimi i Kryetarit të Komunës z.Rufki Suma për privatizimin e „Sharrcemit” pati jehonë të veçantë duke u transmetuar dhe komentuar ne të gjitha mjetet e informimit si atë të gazetave ditore po ashtu edhe në të gjitha mediat elektronike.

Me qëllim të një prezantimi sa më të plotë të Komunës së Hanit të Elezit zyra e transparencës së bashku me një grup punues të propozuar nga Kryetari i Komunës ka përgatitur dhe ka dorëzuar për shtyp edhe një publikim prej afro 100 faqe për Komunën e Hanit të Elezi që do te botohet në 1000 kopje

Gjatë gjithë vitit paralelisht me angazhimet në fushën e informimit pjesë e veprimit ka qenë edhe vendosja e linjave të komunikimit sa më të mirë me mjetet e

informimit,në mënyrë që të bëjmë planifikimet e nevojshme të veprimeve të përbashkëta në vitin 2011

Marsi i vitit 2010 paraqet një sfidë të veçantë për këtë zyre pasi që MAP-së bëri promovimin e projektit të E-qeverisjes-Projekti CSC&CMS, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.07/2008 MSHP –Për forcimin e transparencës dhe standardizimit të faqeve të internetit në institucionet e Republikës së Kosovës,projekt ky i përkrahur edhe nga banka botërore.

Angazhimi i zyrës së transparencës për të përmbushur këto kërkesa dhe standarde rezultoi i suksesshëm dhe në konkurrencë prej 32 komunave , Komuna e jonë ishte njëra nga 10 përfitueset e grantit përkrahës të Bankës Botërore në pajisje teknologjike në vlerë prej ofro 7.000 €

Me qëllim të zbatimit të plotë të këtij projekti është paraqitur nevoja e rrjetit të intranetit ,si dhe përkrahje teknike dhe funksionale e këtij sistemi. Në mungesë të mjeteve tona buxhetore dhe me kërkesë të Kryetarit të Komunës ,MAPL-ja është dakorduar që të financoj projektin „Shtrimi i rrjetit të intranetit në Komunën e Hanit të Elezit” në vlerë prej 18.100€,projekt ky që është realizuar në tërësi dhe për nga performansat dhe pajisjet e instaluara është sistemi më modern dhe më i avancuar në Komunitat e Kosovës .

Me Instalimin dhe funksionalizimit të Skanerit digjital në zyrën e pritjes, sinkronizimin dhe licencimin e serverit të komunës tonë me serverin e MAP-së, dhe konformë me aplikacionet tjera funksionale si qasja interaktive e Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit si dhe të gjithë Drejtorive, në kërkesat e qytetarëve, komuna e jonë është në rrugë shumë të mirë që me fillim të vitit 2011 të jetë një ndër komunitat e para që do të mundë ti plotësoj standardet e kërkuara për E-qeverisje.

I tërë ky proces është përcjellur edhe me trajnime dhe asistencë adekuate të zyrtarëve që do manipulojnë me këtë sistem si nga zyrtari për transparencë ashtu edhe nga kompania „ Data-prognet”që është edhe përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimin të këtyre standardeve.

Vazhdës se plotësimit të nevojave të komunës me pajisje teknologjike duhet ti shtojmë edhe pajisjet nga Grandi i USAID-it në vlerë prej 23.000 euro si dhe 20 Kompjuter nga MAPL-ja ne vlerë prej 10.650 euro , që në total për vitin 2010 në furnizim,implementim dhe mirëmbajtje të teknologjisë informative në Komunën tonë janë investuar afro 60.000 euro ,kurse prej buxhetit të komunës nuk është harxhuar as edhe një cent.

I tërë sistemi i intranetit bazohet në funksionimin e përhershëm , stabil dhe kompatibil me Web-Faqen zyrtare të Komunës , në përputhje me përgjegjësit ligjore që dalin nga udhëzimet administrative

1. Udhëzimit Administrativ Nr.07/2008 MSHP –Për forcimin e transparencës dhe standardizimit të faqeve të internetit në institucionet e Republikës së Kosovës
2. Udhëzimit Administrativ Nr.01/2010 MAP-Mbi qasjen në bazën e të dhënave
3. Udhëzimit Administrativ Nr.02/2010 MAP-Për menaxhimin e sigurisë informative

Sigurisht se pjesë e aktiviteteve shumë të rëndësishme gjatë vitit 2010 kanë qenë edhe trajnimet profesionale të organizuara si nga institucionet vendore ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare , prej te cilave po përmendim ;

- 1.**ECDL- Cerrtifikatë**-Njohuri bazike në Teknologji Informative- Prishtinë
- 2.**ECDL- LICENCË**-Pasaportë Evropiane për Teknologji Informative- Prishtinë

3. **WNG-INTERNATIONAL-Certifikatë**- Ndërtimi dhe funksionimi i Pushtetit Lokal Sofje- Bullgari

4. **SOROS- (IMP)- Certifikatë**-Ngritja e Kapaciteteve të Komunikimit Hani i Elezit

5. **MAPL**- Zhvillimi i transparencës në Komuna nëpërmjet zyrave për Informim-Durrës

Duke qenë edhe zyre ndërlidhëse ndërmjet komunës dhe agjensioneve përkrahëse , zyra e transparencës ka dhënë edhe një kontribut modest në shkëmbim të informatave të nevojshme për; Agjensionin për zhvillim rajonal-Lindje(AZHR-L),SWISS LOGOS-INTERCORPORATION , projektin EULOG ,USAID-in,Komisionin Evropian.

ZYRA LIGJORE

Zyra Ligjore ka përpiluar 48 vendime të cilat janë në Kompetencë të Zyrës së Kryetarit të Komunës, 46 përgjigje në kërkesa, 12 shkresa përcjellëse, 9 marrëveshje mbi çështjen e shpronësimit të pronave private, 2 aktvendime, 10 Autorizime dhe punë të tjera të përditshme.

Në Komisionin për tatim në pronë janë nënshkruar dhe shpërndarë 33 aktvendime, kurse në komisionin disiplinorë gjatë vitit 2010 nuk kemi pasur ndonjë rast të sjelljes para komisionit disiplinor.

Gjithashtu ka marrë pjesë në disa panele të komisionit Intervistues të kandidatëve për punësim dhe ka marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Në punën si përfaqësues Juridik i Komunës ka pasur afërsisht 12 lëndë që i ka përfaqësuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ku dy prej tyre janë përcjellur në Gjykatën e Qarkut njëra në bazë të ankesës së Komunës tonë, kurse tjetra në bazë të Gjykatës Komunale në Kaçanik.

Për të gjitha lëndët përfaqësuesi juridik ka marrë pjesë në seanca në bazë të padive të bërë nga ana e palëve.

Gjatë vitit 2010 Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Zyrave Komunale Ligjore ka organizuar gjithsej 6 takime, brenda Kosovës dhe një takim është organizuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese në Mavrovë të Maqedonisë.

ZYRA E PROKURIMIT

- Zyra e Prokurimit ka udhëhequr të gjitha procedurat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve sipas kërkesave të Drejtorive.
- Kjo zyrë ka dy zyrtar të prokurimit (Shefi dhe zyrtari për prokurim), kjo zyre ka kryer të gjitha procedurat konform ligjit në fuqi 02/L-99 të LPP-së për të gjitha procedurat:
- Minimale deri 1,000.00 €
- Të vogla 1,000.00 – 10,000.00 €(furnizime dhe shërbime)
- Të mesme 10,000.00 – 100,000.00 €
- Të mëdha mbi 100,000.00 €(per furnizime dhe shërbime),kurse për punë mbi 250.000.00 €
- Ne si zyre kemi punuar raportin e prokurimeve të vitit 2010 dhe me këtë raport në vazhdimësi kemi të gjitha procedurat sipas renditjes ose numrit të prokurimit.
- Buxheti total i shpenzuar me procedura të prokurimit është 415,617.12 € nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale.
- Ne raportet në vijim i kemi të shtjelluara konform përshkrimit të lendes dhe vlerës, për të gjitha kategoritë

Procedurat mbi 1,000.00 € të Komunës së Hanit të Elezit

Nr	Pershkrimi i lëndës	Data e shpalljes	Data e hapjes	Data e Vlerësimit	Data e Kontratës	Vlera e kontratës	Firma
1	Furnizim me material, sherbimi i renovimit te zyres se kryetarit dhe shtepise se te vetmuarve	19.02.2010	01.03.2010	01.03.2010	26.03.2010	3,527.56	NTN "SUVATIMI"
2	Furnizim me material dhe sherbimi i instalimit elektrik te zyres se kryetarit dhe te shtepise se te vetmuarve ne Han te Elezit	30.04.2010	11.05.2010	11.05.2010	18.05.2010	4,819.98	NTSH "ELEKTRA"
3	Mirembajtja dhe srvisimi I veturave Hyunday Accent dhe SANTA Fe te	30.04.2010	11.05.2010	11.05.2010	18.05.2010	1,616.00	NTP "BESA"
4	Mirembajtja dhe srvisimi I veturave Toyota Runner dhe Golf IV	09.03.2010	18.03.2010	18.03.2010	26.03.2010	3,994.00	NTP "BESA"
5	Furnizim me material higjienik per nevojat e administrates komunale, shkolla QKMF, Zjarrfiksa etj	22.03.2010	31.03.2010	31.03.2010	20.04.2010	9,733.23	NT "ATLLAS"
6	Furnizim me material shpenzues per nevojat e administrates komunale dhe shkollat e Hanit te Elezit	01.04.2010	12.04.2010	13.04.2010	19.04.2010	7,726.50	NTP "LOKI"
7	Furnizim me material per ndertimin e rruges se Kagjes Rana - Hani i Elezit	26.03.2010	06.04.2010	06.04.2010	12.04.2010	9,957.00	NN. "RINIA"
8	Furnizim me medikamente per QKMF	26.04.2010	05.05.2010	05.05.2010	20.05.2010	5,220.50	"ATOM_MED"
9	Transporti, qendrimi dhe ushqimi ne Shqiperi per arsimtaret e shkollave te Hanit te Elezit	07.05.2010	17.05.2010	17.05.2010	21.05.2010	8,190.00	NT. "ELITA TOURS"
10	Furnizim me material per mirembajtje, per ujesjelles, kanalizim, material elektrik etj	09.07.2010	19.07.2010	19.07.2010	18.08.2010	3,711.50	"SFERA"
11	Sigurimi i veturave zyrtare te administrates komunale, shendetesise etj	05.05.2010	14.05.2010	17.05.2010	26.05.2010	2,195.65	K.S. "DARDANIA"

12	Furnizim me inventar per nevojat e administrates komunale	07.05.2010	17.05.2010	17.05.2010	21.05.2010	3,265.00	NNP "MOBEST"
13	Nderrimi i timonit te autoambulances(dhurate) se QKMF-se Hani i Elezit	07.07.2010	16.07.2010	16.07.2010	21.07.2010	1,700.00	"VOLSWAGEN"
14	Transporti I personave me Hemodialize	11.05.2010	21.05.2010	21.05.2010	01.06.2010	3,194.23	Auto TAXI S.AXHAMI
15	Punimi ne aneks-shkolles se Paldenices	20.05.2010	21.06.2010	25.06.2010	23.08.2010	35,888.72	NTP "ARTI"
16	Punimi i kanalizimit te fshatit Seqishtë	02.07.2010	27.07.2010	3.08 €	20.08.2010	17,127.00	shpk. "Linda"
17	Furnizim me tepisona dhe perde per zyret e administrates komunale	01.07.2010	12.07.2010	12.07.2010	21.07.2010	2,479.70	NT. "ATLLAS"
18	Shtrimi me kubeza betoni I disa rrugicave te Hanit te Elezit	25.06.2010	26.07.2010	30.07.2010	18.08.2010	45,314.28	NTP "ARBRINI"
19	Punimi i kanalizimit ne disa pjese te qytetit	30.06.2010	26.07.2010	30.07.2010	17.08.2010	38,767.60	NNP "BARDHI"
20	Furnizim me nafte	27.08.2010	21.09.2010 (27.08.2010)	30.09.2010	18.10.2010	2,813.53	NTSH. "ALBA OIL"
21	Furnizim me paisje te IT-se	09.12.2010	15.12.2010	15.12.2010	20.12.2010	3,190.00	NSH. "Ceti Computers"
22	Furnizim me Air-Conditioner per zyret e administrates komunale	20.09.2010	30.09.2010	30.09.2010	08.10.2010	6,490.20	NTSH "ELEKTRA"
23	Shkallet emergjente per shk.Illaz Thaçi" Hani i Elezit	13.07.2010	06.08.2010	10.08.2010	13.09.2010	15,538.00	NN. "Beni Constructions "
24	Mirembajtja dimërore e rrugëve te Hanit te Elezit	procedure ne zhvillim					
25	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi i shkollave, komunes dhe QKMF-se	06.09.2010	16.09.2010	16.09.2010	23.09.2010	6,090.00	NPSH "ECOPROJE CT"
26	Shtrimi me zhavor per disa rrugica te Hanit te Elezit	21.09.2010	30.09.2010	01.10.2010	28.10.2010	6,133.00	shpk."Guri I Bekuar"
27	Suvatimi i zyreve te komunes	21.09.2010	30.09.2010	30.09.2010	08.10.2010	5,742.00	NTN "SUVATIMI"
28	Furnizim me dru per nevojat e SHCK-se, Shkollave dhe Ambulantes se Gorances - shkurtimi i tyre	12.10.2010	22.10.2010	25.10.2010	05.11.2010	7,018.26	NNP "AHU"
29	Rregullimi i Hapsirave Publike per Hanin e Elezit	30.09.2010	25.10.2010	27.10.2010	11.11.2010	30,587.50	NTP "3 D-Project"

30	Mirembajtja dhe servisimi i vetures se APK-se Landrover	19.10.2010	29.10.2010	29.10.2010	02.11.2010	1,488.00	NTP "BESA"
31	Furnizim me material dhe punimi i hyrjes ne shkollën e Paldenices - Aneks	09.11.2010	19.11.2010	19.11.2010	22.11.2010	4,992.68	NTP "ARTI"
32	Grumbullimi i ujit ne fsh.Glloboqice	11.11.2010	22.11.2010	23.11.2010	26.11.2010	9,996.00	NT "Besi Comerc"
33	Asfaltimi i rruges se fshatit Laç	13.12.2010	13.12.2010	13.12.2010	16.12.2010	9,985.16	Escavatori Company
34	Hartimi i projekteve	07.12.2010	13.12.2010	13.12.2010	16.12.2010	6,418.80	NNP "KOING"
35	Furnizim me inventar per nevojat e shkollave	03.12.2010	10.12.2010	10.12.2010	14.12.2010	2,176.00	NTZ "MOBEST"
36	Eliminimi i qenëve endacak						
37	Meremetimi i rruges Lagja e re	08.12.2010	14.12.2010	14.12.2010	16.12.2010	6,687.79	Escavatori Company
38	Shtrim me kubeza betoni per disa rrugica	08.12.2010	13.12.2010	13.12.2010	16.12.2010	8,961.70	N.P " KRAS"
39	Shtrim me zhavor per rruget e fshatrave te H.Elezit	09.12.2010	14.12.2010	14.12.2010	17.12.2010	9,400.00	shpk."Guri i Bekuar"
40	Furnizim me dhurata te vitit te ri	15.12.2010	20.12.2010	20.12.2010	23.12.2010	2,499.00	DPT."Preni Comerc"
	Transporti i personave me Hemodizlize	kontrate 1 vjeqare	nentori 2009	qershor	01.06.2009 gjer me 01.06.2010	4,856.82	A.TAXI S.AXHAMI
	Transporti i personave me Hemodializë	Kontrate 1 vjeqare	qershor 2010	gusht	01.06.2010 gjer me 31.08.2010	3,572.88	A.TAXI S.AXHAMI
	Derivate QKMF-ja	kontrate 1 vjeqare	tetor 2009	Maj	15.10.2009 gjer me 15.10.2010	6,107.46	NTP "SHKENDIA"
	Derivate arsimit (vaj per ngrohje)	kontrate 1 vjeqare	tetor 2010	Maj	15.10.2009 gjer me 15.10.2010	7,920.00	NTP "SHKENDIA"
	Naftë për nevoja te komunës,	kontrate 1 vjeqare	tetor 2011	Maj	15.10.2009 gjer me 15.10.2010	14,050.99	NTP "SHKENDIA"
	Derivate për arsim (vaj per ngrohje)	kontrate 1 vjeqare			tetor 2010 gjer tetor 2011	7,403.00	NTSH "ALBA OIL"

Gjithsej:

399,447.22 €

Procedurat (Ofertat) nën 1000 €

N r	Pershkrimi i lëndës	Data e shpalljes	Data e Kontrates	Vlera e kontrates	Operatori
1	Furnizim me kalendar dhe notesa per nevojat e komunes Hani i Elezit	14.04.2010	20.04.2010	975	NT. " ATLLAS"
2	Furnizim me material per veturen zyrtare te kryetarit te komunes	15.03.2010	13.04.2010	609	NPT. " V W"
3	Pastrimi i pusetave dhe hapja e kanalizimeve te nxena në Han te Elezit	23.02.2010	26.02.2010	580	"LYPETENI"
4	Evitimi i defektit tek shperthimi i ujesjellsit afër QKMF-se	03.03.2010	16.03.2010	630	"KRAS"
5	Riparimi i gjeneratorit te shkolles se fshatit Gorance	16.03.2010	31.03.2010	160	"WAT"
6	Furnizim me flamuj kombetar dhe shteteror per Komune e Hanit te Elezit	08.03.2010	15.03.2010	360	"ABC"
7	Hapja e rruges te lagja e re nga shembjet e dheut	25.03.2010	31.03.2010	260	"LURI"
8	Furnizim me libra te UÇK-se per Komunen e Hanit te Elezit	09.07.2010	18.08.2010	840	"ABC"
9	Mirembajtja e kamionit te zjarriksave tipit FIA	13.05.2010	18.05.2010	279	"BESA"
10	Furnizim me lektyra shkollore per shkollen e fshatit Paldenice	20.05.2010	01.06.2010	246	"KORABI"
11	Furnizim me libra te UÇK-se per Komunen e Hanit te Elezit	09.07.2010	18.08.2010	840	"ABC"
12	Furnizim me veshmbathje per sigurimin dhe mirembajtjes e komunes	15.09.2010	05.10.2010	288	"SANKOS"
13	Sherbimi i piketimit te rrugeve te Hanit te Elezit	30.09.2010	06.10.2010	890.6	"GEODATA"
14	Furnizim me material per nevojat e shkollave	16.07.2010	07.09.2010	581	"ABC"
15	Furnizim me material shpenzues dhe material sportiv per komune	20.07.2010	18.08.2010	945	"ABC"
16	Transporti i semimaturanteve neper Kosove	10.12.2010	14.12.2010	996	"ELITA TOURS"
17	Furnizim me ngjyra dhe tonera per nevojat e Komunes	13.12.2010	16.12.2010	988	"COMTRADE"

18	Furnizim me pisha dhe blina per nevojat e komunes	13.12.2010	15.12.2010	995	"IDEAL"
19	Transporti i maturanteve ne Shqiperi	16.12.2010	21.12.2010	824	"ELITA TOURS"
20	Furnizime te ndryshme per shkolla	20.12.2010	23.12.2010	999.3	"ABC"
21	Furnizim me tonera dhe printer per zyre	20.12.2010	23.12.2010	971	"Ceti Computers"
22	Furnizim me goma dhe paisje percjellese per vetura	20.12.2010	23.12.2010	650	"V W"
23	Mbishkrimi i Shtepisë së Kultures "Imri Curri"	21.12.2010	23.12.2010	120	"KROSA"
24	Furnizim me pasije te ndryshme per veturat zyrtare	21.09.2010	12.10.2010	493	"V W"
25	Nderrimi i ndrr.shpejtsive te kamionit IFA	26.10.2010	04.11.2010	650	"BESA"
SHUMA				16,169.90	

Te gjitha keto procedura jane te udhehequra konform ligjit te prokurimit 02/L-99 te LPP-së
Vlera e furnizimeve,puneve dhe sherbimeve eshte 415,617.12 € sipas te gjitha nevojave per administraten komunale, shkollat, QKMF-ne, Shtepinë e Zjarrëfiksave dhe Agjensionin Pyjor Komunal.